

Shteti i Austrisë së Epërme dhe Dhoma e Punëtorëve në Austrinë e Epërme krijojnë „Fondin e Vështërsive të Koronës“ për të mbështetur punonjësit dhe familjet e tyre.

Kush ka të drejtë?

Të drejtë kanë personat të cilët para shfaqjes së Koronës kanë qenë të punësuar dhe jetesën e tyre e kanë siguruar nga të ardhurat si të punësuar dhe të cilët në muajin Dhjetor 2020 dhe Janar 2021 për shkak të Krizës së Koronës kanë mbetur të papunë ose kanë pasur ulje të pagave gjatë shkurtimit të orëve të punës.

Për të bërë krahasimin e reduktimit të të ardhurave është vendimtare rroga e muajit të fundit para se të jeni i regjistruar si i papunë ose shkurtimit të orëve të punës. Nëse papunësia juaj ka filluar me fillimin e pandemisë COVID -19 në muajin Mars, atëherë si krahasim do të merret parasysh rroga juaj nga muaji shkurt i vitit 2020.

Sa finanzohet?

Kjo ndihmë jepet si një shumë e njëhershme për familje. Kjo shumë është e pakthyeshme.

Nëse keni të paktën 20 përqind ulje të të ardhurave:

- Personat që jetojnë vetëm deri më 1.300 Euro
- Dy persona deri më 2.000 Euro
- Çdo person i rritur i punësuar 1000 Euro
- Çdo person i mitur 250 Euro

Shuma e ndihmës është nëse keni të paktën 20 përqind ulje të të ardhurave (Shumë e njëhershme):

- Një person në shtëpi: 300 Euro
- Dy persona në shtëpi : 400 Euro
- Tre persona dhe më shumë: 500 Euro

Nëse keni të paktën 30 përqind ulje të të ardhurave:

- Personat që jetojnë vetëm deri më 1.500 Euro
- Dy persona deri më 2.400 Euro
- Çdo person i rritur i punësuar 1000 Euro
- Çdo person i mitur 250 Euro

Shuma e ndihmës është nëse keni të paktën 30 përqind ulje të të ardhurave (Shumë e njëhershme):

- Një person në shtëpi: 500 Euro
- Dy persona në shtëpi: 600 Euro
- Tre persona dhe më shumë: 700 Euro

Një kusht tjetër është që vendbanimi kryesorë i të gjithë anëtarëve të një familje të jetë në Austrinë e Epërme që nga 1 shkurti i 2020, të jenë në gjendje të vështirë financiare përshkak të shkurtimit të orëve të punës, të papunësisë, të mos kenë të drejtë për ndihmë ligjore (ndihmë sociale). Aplikimet mund të dorëzohen në mënyrë elektronike në Zyrën e Qeverisë së Shtetit të Austrisë së Epërme që nga 08.02.2021 deri më 31.03.2021. Personat që nuk kanë kompjuter ose

Smartphone, mund t'a dorëzojnë aplikacionin e tyre në mënyrë elektronike në qendrën e AK -së ose në zyrat e rrethit.

Nëse keni nevojë për ndihmë ose keni pyetje, punonjësit e Qendrës për Migrantët në Austrinë e Epërme – migrare, janë në dispozicionin tuaj.

Për momentin ne mund të kontaktojmë vetëm përmes telefonit 0676 846954601, ose postës elektronike: beratung@migrare.at